



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:074115  
Datë: 25.11.2024  
Numri i dokumentit: 06503762

C.nr.1882/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Albana Çeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.T, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve....., me seli në ....., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë (DKA), me objekt kontesti, kompensimin e shujtave ditore (ushqimit), jashtë seancës gjyqësore, më datë 25.11.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit A.T nga P. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të kompensimit për shujta ditore (ushqim) gjatë ditëve të pranisë në punë, për periudhën nga data 19.04.2021 deri me datën 22.11.2022 për 332 ditë, t’ia kompensoi shumën prej 664.00 €, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë datë 22.03.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124,00 € në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datën 22.03.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës–Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, për kompensimin e shujtave ditore (ushqimit).

I autorizuari i paditësit në padinë dhe precizimin e padisë, ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura si mësimdhënës në Gjimnazin e Shkencave Shoqërore, “....” në P.

Ka shtuar se paditësi nga data 19.04.2021 e deri me datën 22.11.2022 për kohën që kjo kontratë ka qenë në fuqi nuk është kompensuar me nga dy euro, për secilën ditë të pranisë në punë edhe pse kjo e drejtë i është garantuar. Paditësi gjatë kësaj periudhe kohore ka punuar gjithsejtë 332 ditë pune e nëse përlllogaritet secila ditë pune me nga dy Euro, atëherë shuma që do të duhej të kompensohej paditësit në emër të shujtave ditore (ushqimit) për ditët e pranisë në punë do të ishte në lartësi prej 664.00 €.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të pranuar në gjykatë me datë 13.11.2024 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me pretendimin se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, e po ashtu e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Po ashtu, në rastin konkret ekziston edhe parashkrimi i kërkesës pasi konform dispozitave të Ligjit të Punës të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku parashihet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*, kjo pasi që në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditëses aprovohet në tersi si e bazuar, për arsye se:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se, në mes të palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga kontrata e punës me numër të protokollit 30/89/1 e datës 25.01.2018 dhe vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë me numër të protokollit nr.prot.2295/3 datë 14.11.2024.

Gjykata kontratës së punës dhe vërtetimit për ditët e pranisë në punë, ua fali në tërësi besimin me rastin e vendosjes sa i përket lartësisë së kërkesëpadiisë së paditësit, kjo sepse nga të njëjtat u konstatua se paditësi A.T nga data 19.04.2021 e deri me datën 22.11.2022, ka realizuar gjithsej 332 ditë pune.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiisë, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Kjo për faktin se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e shpenzimeve të shujtave ditore (ushqimit) për periudhën kohore nga data 19.04.2021 e deri me datën 22.11.2022 gjenë mbështetje në Kontraten Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Gjykata, duke u bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës në këtë çështje juridike kontestimore, ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar. Kjo ngase në bazë të shkresave të lëndës është vërtetuar se paditësi, ka qenë dhe është në marrëdhënie pune tek e paditura. Andaj bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ku shprehimisht parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy 2.00 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në Institucionet Arsimore”*. Mbi këtë bazë e duke u bazuar në vërtetimin e ditëve të prezencës në punë, nga të cilat rezulton që paditësi ka qenë prezentë në punë gjithsej 332 ditë për periudhën të cilën kërkon kompensimin i bie që për 332 ditë pune nga 2 euro (332 x 2.00€), vlera totale e kompensimit për ushqim gjatë punës të jetë 664.00 €.

Në rastin konkret, gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje vlerësoi dispozitat ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë ku me nenin 2 paragrafi 1, pika 1.1 të saj parashihet *“Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë shkolla speciale e qendra të kompetencës), dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilat janë anëtarë të SBASHK-ut, dhe pika 1.2 “Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e Institucioneve të Arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukative – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*. Marrë parasysh se kontrata është e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, rrjedhimisht, sipas kësaj kontrate komunat respektivisht Drejtoritë Komunale të Arsimit, si punëdhënëse janë të obliguar që ta zbatojnë. Andaj dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë shkolla speciale e qendra të kompetencës), që do të thotë se në rastin konkret të gjithë të punësuarve në sektorin e arsimit, ju takon kjo e drejtë.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiës me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën për një kompensim të tillë, mirëpo këta pretendime gjykata i refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiës sikurse u tha më lartë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e vitit 2017 dhe pastaj edhe ajo e vitit 2021.

Ndërsa sa i përket pretendimeve lidhur me mungesën e buxhetit edhe këto pretendime sipas vlerësimit të gjykatës janë të pabazuara dhe nuk gjejnë mbështetje në asnjë normë ligjore të aplikueshme, e për më tepër gjykata i vlerësoi si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësja nuk është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit, për zbatimin e vendimit të lartcekur nuk e lirojnë të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Lidhur me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka vlerësuar se e njëjta rrjedhë për pagesë nga data e parashtrimit të padisë datë 22.0.2023, kjo bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Mendimit Juridik për Kamatat të Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në ne nenin 452 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-118 dhe në Rregulloren për Tarifat e Avokateve, sipas së cilës paditësit u pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 124.00 Euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 Euro dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 20.00 Euro.

Gjykata, bazuar në nenin 453, paragrafi 1 dhe 2, të LPK-së ku është përcaktuar “ *Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. Po që se është parashikuar tarifa për shpërblimin e avokatëve, apo për shpenzimet tjera, atëherë këto shpenzime do të matën sipas tarifës së tillë*”.

Andaj, gjykata nuk ka njohur shpenzimet përtej shumes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që kanë të bëjnë me shpenzimet lidhur me aplikimin e tatimit në vlerë të shtuar (TVSH) mbi shumën e shpenzimeve të procedurës se njohur nga gjykata dhe shpenzimet për precizin e padisë në kuptimin objektiv, pasi që në vlerësimin e gjykatës një kërkesë e tille nuk gjenë mbështetje në Rregulloren për Tarifat e Avokateve dhe LPK. Përfshirja e përfaqësuesit të palës në tatimet e aplikueshme në Kosovë, në rastin konkret TVSH, nuk mund të reflektoj dhe tejkaloj tarifën e përcaktuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës për shërbimet e ofruara nga anëtarët e saj.

Bazuar në të lartcekurat, në bazë të nenit 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.1882/2023, datë 25.11.2024.

G j y q t a r j a  
Albana Çeku

#### UDHËZIM JURIDIK MBI TË DREJTËN E ANKESËS

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa, përmes kësaj gjykate i drejtohet Gjykatës së Apelit, Prishtinë.